

Levica Plena
[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____, 2024

Lënda: Nismë për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë””

Drejtuar: Znj. Lindita Nikolla
Kryetare e Kuvendit

E nderuar znj. Kryetare,

Në mbështetje të nenit 81 pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 68 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e deputetit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend nismën për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa në Ligjin Nr. 15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë””.

Ju lutem gjeni bashkëlidhur tekstin e projektligjit dhe relacionin shoqërues të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Me respekt,

Deputeti propozues

Evis KUSHI

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2024

PËR

DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 15/2017, DATË 16.02.2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozim të një deputeti, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

VENDOSI

Në ligjin nr. 15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, bëhen shtesat si më poshtë:

Neni 1

Pas nenit 12 “Ofruesit e AFP-së”, shtohet neni 12/1, me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 12/1

Programet e përbashkëta të studimit

1. Ministria përgjegjëse për AFP ose institucionet publike ofruese të AFP/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardeve, të kualifikimeve profesionale, kanë të drejtë të lidhin marrëveshje me institucione arsimore të huaja të njohura ndërkombëtare ose organizma ndërkombëtare, me qëllim lëshimin e diplomave/certifikatave të përbashkëta ose të dyfishta nga institucionet pjesëmarrëse.
2. Shpenzimet e mundshme për zbatimin e këtyre marrëveshjeve, sipas rastit, përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për institucionet publike ofruese të AFP/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ose burime të tjera të ligjshme, të rregulluara me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP.
3. Efektet financiare për angazhimet në marrëveshje, sipas rastit, kur mbulojnë nga institucioni publik ofrues i AFP/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, sipas parashikimeve të marrëveshjes, nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik, por rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për AFP.

4. Institucionet publike ofruese të AFP, përpara lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit dhe për hapjen e programeve të përbashkëta ose të dyfishta të studimit, marrin miratimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për AFP.

Neni 2

Në pikën 4, të nenit 16 “Kualifikimet profesionale dhe nivelet përkatëse”, pas shkronjës “b”, shtohen shkronjat “c” dhe “ç”, me përmbajtje si më poshtë:

“c) Me përfundimin e arsimit të mesëm profesional, i orientuar sipas drejtimeve të gjera profesionale, me kohëzgjatje 3 vite shkollë pas përfundimit të arsimit bazë, mund të përftohet niveli 3 i KSHK-së. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë profesionale të maturës shkollë profesionale (shkollës së mesme) dhe lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në kursin urë të përgjithshëm ose në tregun e punës.

ç) Me përfundimin e arsimit të mesëm profesional, i orientuar sipas profileve profesionale për çdo drejtim profesional, me kohëzgjatje 1 vit shkollë, pas përfundimit të arsimit profesional bazë, mund të përftohet niveli 3 i KSHK-së. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë profesionale të maturës shkollë profesionale (shkollës së mesme) dhe lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në kursin urë të përgjithshëm ose në tregun e punës.”

Neni 3

Në nenin 25 “Akreditimi”, pas pikës 2, shtohet pika 3, me përmbajtje si më poshtë:

“3. Shpenzimet për akreditimin përballohen nga vetë institucionet ofruese të AFP, sipas tarifave të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Ngarkohen ministri përgjegjës për financat dhe ministri përgjegjës për AFP për nxjerrjen e udhëzimit sipas pikës 3 të nenit 1 të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE

LINDITA NIKOLLA

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” ”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektligji lidhet me nevojën për të përditësuar kurrikulat, njohuritë dhe shërbimet që ofrohen nga institucionet publike të AFP me eksperiencën e vendeve me traditë dhe histori në fushën e arsimit profesional, për rritjen e cilësisë dhe standardeve, të kualifikimeve profesionale, duke garantuar të rinj dhe të reja me kompetenca bashkëkohore dhe duke mundësuar një punësim të menjëhershëm, të denjë dhe të mirëpaguar.

Objektivat që synohen, konsistojnë në:

- lidhjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit nga ana e ministrisë përgjegjëse për AFP ose institucioneve publike ofruese të AFP me institucione arsimore të njohura ndërkombëtare ose organizma ndërkombëtare, të cilat kryejnë aktivitetin jashtë vendit;
- lëshimin e diplomave/certifikatave të përbashkëta ose të dyfishta nga institucionet pjesëmarrëse;
- përmirësimin e kurrikulave, njohurive dhe nivelin e shërbimit të ofruesit publik të AFP;
- rritjen e numrit të të rinjve që duan të ndjekin studimet në ofruesit publikë të AFP.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT, LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Nëpërmjet zbatimit të këtij projektligji, pritet që:

- Institucioneve publike ofruese të AFP t'u krijohet mundësia për të bashkëpunuar me institucione arsimore të njohura ndërkombëtare ose organizma ndërkombëtare, të cilat kryejnë veprimtari në fushën e AFP, duke synuar ofrimin e eksperiencave më të mira dhe lëshimin e diplomave/certifikatave të përbashkëta ose të dyfishta.
- Kurrikulat, njohuritë dhe shërbimet e ofruara nga institucionet publike të ofrimit të AFP, t'u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe kërkesave të komunitetit të biznesit, duke ndikuar ndjeshëm në kualifikimin profesional të të rinjve që përfundojnë studimet në shkollat profesionale.
- Të rritet bashkëpunimi me biznesin, të cilët jo vetëm do të garantojnë mjedisin për praktikantë profesionale, por gjithashtu do të kenë mundësi për të punësuar të rinj të mirëkualifikuar, të cilët do të ndikojnë në rritjen dhe përmirësimin e shërbimeve që këto biznese ofrojnë.
- Të krijojë mundësinë që nxënësit, që nuk dëshirojnë të vazhdojnë studimet e larta por duan të integrohen shpejt në tregun e punës, të përfundojnë studimet në vitin e tretë dhe të pajisen me certifikatë profesionale të maturës shkollore profesionale.
- T'u krijojë mundësinë nxënësve në shkollat profesionale, që duan të vijojnë arsimin e lartë ose pas të mesëm, të ndjekin shkollimin teknik-menaxherial 1 vjeçar dhe të fitojnë maturën shtetërore profesionale, ose kursin urë të përgjithshëm 1 vjeçar dhe të fitojnë maturën shtetërore (të përgjithshme).

- Të sigurojë koherencën me strukturat e arsimit profesional të vendeve të Bashkimit Europian duke lehtësuar mobilitetin dhe integrimin edhe në tregun rajonal të punës, të nxënësve që kanë fituar maturën shkollore profesionale.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji që paraqitet për shqyrtim bazohet në nenin 81 pika 1 e Kushtetutës.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Nuk bën pjesë në aktet që kërkohet të ketë përafrim me “acquis communautaire”.

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKAKTIT

Në ligjin Nr. 15/2017, datë 16.02.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” bëhen shtesat si më poshtë:

Pas nenit 12 “Ofruesit e AFP-së”, shtohet neni 12/1 “Programet e përbashkëta të studimit”, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ministria përgjegjëse për AFP ose institucionet publike ofruese të AFP/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardeve, të kualifikimeve profesionale, kanë të drejtë të lidhin marrëveshje me institucione arsimore të huaja të njohura ndërkombëtare ose organizma ndërkombëtare, me qëllim lëshimin e diplomave/certifikatave të përbashkëta ose të dyfishta nga institucionet pjesëmarrëse.
2. Shpenzimet e mundshme për zbatimin e këtyre marrëveshjeve, sipas rastit, përballohen nga fondet buxhetore të miratuara për institucionet publike ofruese të AFP/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ose burime të tjera të ligjshme, të rregulluara me udhëzim të ministrit përgjegjës për AFP.
3. Efektet financiare për angazhimet në marrëveshje, sipas rastit, kur mbulohen nga institucioni publik ofrues i AFP/Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, sipas parashikimeve të marrëveshjes, nuk i nënshtrohen rregullave të prokurimit publik, por rregullohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit përgjegjës për AFP.
4. Institucionet publike ofruese të AFP, përpara lidhjes së marrëveshjes së bashkëpunimit dhe për hapjen e programeve të përbashkëta ose të dyfishta të studimit, marrin miratimin paraprak të ministrit përgjegjës për AFP.

Në pikën 4, të nenit 16 “Kualifikimet profesionale dhe nivelet përkatëse”, pas shkronjës “b”, shtohen shkronjat “c” dhe “ç”, me përmbajtje si më poshtë:

“c) Me përfundimin e arsimit të mesëm profesional, i orientuar sipas drejttimeve të gjera profesionale, me kohëzgjatje 3 vite shkollore pas përfundimit të arsimit bazë, mund të përftohet niveli 3 i KSHK-së. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë profesionale të maturës shkollore profesionale (shkollës së mesme) dhe lejon kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në kursin urë të përgjithshëm ose në tregun e punës.

ç) Me përfundimin e arsimit të mesëm profesional, i orientuar sipas profileve profesionale për çdo drejtim profesional, me kohëzgjatje 1 vit shkollor, pas përfundimit të arsimit profesional bazë, mund të përftohet niveli 3 i KSHK-së. Ky nivel arsimor përfundon me certifikatë profesionale të maturës shkollore profesionale (shkollës së mesme) dhe lejon

kalimin në nivel më të lartë të arsimit profesional, në kursin urë të përgjithshëm ose në tregun e punës.”

Në nenin 25 “Akreditimi”, pas pikës 2, shtohet pika 3, me përmbajtje si më poshtë:
“3. Shpenzimet për akreditimin përballohen nga vetë institucionet ofruese të AFP, sipas tarifave të përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave.”

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësve, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe ofruesit publikë të AFP.

VII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTVENDIMIT

Projektligji është nismë deputeti.

VIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Efektet financiare do të përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit të planifikuara për Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, në programin për arsimin profesional.

Deputeti propozues

EVIS KUSHI